

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "Pure Fruit Pro" Sh.p.k.**

Sot, më datë 15 / 11 /2024,

- **Zj. Eltona Koçi**, shtetase shqiptare, lindur me 21/03/1981, ne Vore, mbajtese e dokumentit te identifikimit me nr. personal I15321096O, madhore e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

Në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit", ka vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Pure Fruit Pro" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "Pure Fruit Pro" Sh.p.k.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Lagja Skenderbej, Zona industriale jug, godina 28/1 Zona kadastrale 8523, Elbasan.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

Përpunimin dhe tregtimin e produkteve të frutave. Aktivitetet do të përfshijnë prodhimin e lëngjeve dhe koncentreve frutash, tharjen dhe përpunimin e frutave për krijimin e produkteve të ndryshme si reçel, marmelata, pure, pluhur mjeksor dhe vajra esenciale.

Prodhim vaji nga cdo lloj fruti si dhe aktivitet i fruta-perimeve drejt industrise ushqimore si dhe shitjen e këtyre produkteve në tregje të ndryshme. Kompania do të përmbushë standardet e sigurisë ushqimore dhe do të respektojë rregulloret për ruajtjen dhe përpunimin e ushqimeve të sigurt.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e



aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

#### **NENI 5**

##### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 2.000.000 Lekë (*dy milion*) Lekë dhe është i përbërë nga 1 kuote.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Zj. Eltona Koçi**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2.000.000 Leke (*dy milion*) Lekë dhe 2.000.000 Leke (*dy milion*) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

#### **NENI 6**

##### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

**Zj. Ibadete Sula**, shtetase shqiptare, lindur me 23/10/1999, ne Elbasan, mbajtese e dokumentit te identifikimit me nr. personal J96023014A, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administratore për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

#### **NENI 7**

##### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 8**

##### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku i vetem themelues i shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Zj. Ibadete Sula** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

#### **ORTAKU THEMELUES**

**ELTONA KOÇI**

Eltona Koçi 